

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka realizuar progresin e mëposhtëm për objektivat:

1. Përafrimi i legjislacionit në fushën e standardizimit me atë të BE

- Draft Vendimi i Këshillit të Ministrave “Rregullore për Veprimtarinë e Standardizimit”, e cila transponon Rregulloren e BE nr.1025/2012 “Mbi Standardizimin Europian” u dërgua dërguar nga MFE për miratim në Këshillin e Ministrave në Maj 2017. Megjithë parashikimin sipas PKIE 2016-2020 për t’u miratuar brenda 6 mujorit të parë 2017, ky afat nuk u realizua. Miratimi i saj është shtyrë për 6 mujorin e parë 2018.
- DPS lidhi 2 marrëveshje të reja me Komitetin Europian për Standardizimin (CEN) dhe me Komitetin Europian për Standardizimin në fushën e Elektroteknikës (CENELEC) në Maj 2017. Marrëveshjet janë në zbatim të Rregullores së BE nr.1025/2012 “Mbi Standardizimin Europian” dhe parashikojnë të drejta dhe detyrime të palëve (DPS – CEN) dhe DPS – CENELEC) lidhur me statusin Affiliate të DPS-së në këto organizma. Gjithashtu, zbatimi i këtyre Marrëveshjeve është në mbështetje të konkurrueshmërisë së ndershme të biznesit dhe industrisë në vend, duke kontribuar në lehtësimin e pengesave teknike për tregtinë dhe aksesin në tregun e përbashkët. Periudha pas nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve u shoqërua me disa trajnime *online* për stafin e DPS për të punuar sipas mjeteve dhe platformave të reja të IT që CEN & CENELEC kanë lançuar për marrjen e standardeve EN nga baza e tyre e të dhënave, njoftimet, miratimi i EN dhe publikime të tjera të CEN e CENELEC, IPR dhe shitje të standardeve.
- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 4 mbledhje të Bordeve të DPS-së, përkatësisht 2 mbledhje të Bordit Drejtues dhe 2 mbledhje të Bordit Teknik.

2. Adoptimi i Standardeve

- u adoptuan në total **2,839** standarde nga të cilat:
 - **2,146** janë Standarde Europiane ose rreth 97% e totalit të standardeve të CEN dhe CENELEC;
 - **693** janë Standarde Ndërkombëtare.

Janë adoptuar **100%** standardet europiane të harmonizuara si standarde Shqiptare të harmonizuara.

Problem mbetet adoptimi i tyre vetëm me përkthim të faqes së parë.

3. Komunikimi/Marrëdhëniet me publikun

- Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar *online* në www.dps.gov.al përfshirë këtu edhe takimet dhe dokumentat e miratuara nga Bordi Drejtues, rregulloret, buletinet, Katalogu i Standardeve Shqiptare, njoftime në Sekretariatit e ISO / IEC dhe CEFTA, artikuj të ndryshëm promovues, takimet me student dhe palë të interesuara, standardi më i ri i publikuar nga DPS.
- Janë publikuar rreth **26** artikuj promovues dhe **156** ekstrakte të fushave për standarde me interes për biznesin dhe ekonominë.
- Numri i klikimeve është rritur ndjeshëm këtë vit krahasuar me vitet e kaluara - Në total janë marrë më shumë se **38,600 klikime** për publikimet në mediat sociale: [DPS facebook](#) [DPS Google +](#) dhe [DPS LinkedIn](#).
- Është publikuar dhe shpërndarë Katalogu i Standardeve Shqiptare 2017 në të dyja versionet me letër dhe me CD.
- Janë publikuar dhe shpërndarë **5** Buletinët Informativë të DPS dhe janë kontaktuar kompani biznesi të ndryshme, ku i është dhënë informacion mbi standardet, zbatimin e tyre, çertifikimin dhe mbi skarcot/humbjet gjatë procesit të prodhimit;
- Janë notifikuar dhe bërë të disponueshme për publikun të gjitha draft aktet ligjore e nënligjore të ministrive të linjës me ndikim në tregti.

4. Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve

- U realizua në kohë dhe më cilësi përfshirja e porosisë *online* për shitjen e Standardeve Shqiptare, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj biznesit dhe cdo pale tjetër të interesuar për standarde, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve.

5. Bashkëpunimi me homologët në fushën e standardizimit

DPS ka vazhduar të bashkëpunojë me homologët në Rajon e më gjerë në zbatim të Marrëveshjeve që ajo ka lidhur me ta, si dhe ka marrë pjesë në Konferencën Ballkanike të Standardizimit, mbajtur në Antalia – Turqi. Në këtë takim DPS shprehu interes të veçantë për Inisiativat e Përbashkëta (Joint Initiative) të Komisionit Europian dhe u arrit që vendet pjesëmarrëse të krijojnë një grup pune, me 3 përfaqësues nga NSB-të pjesëmarrëse, të cilët do të hartojnë një dokument/kërkesë për të diskutuar dhe nënshkruar një Inisiativë të Përbashkët me Komisionin Europian.

Qëllimi i kësaj marrëdhënieje me Komisionin Europian është që, BE të asistojë vendet tona nga ana financiare dhe jo vetëm, lidhur me nevojat tona për të përmirësuar zbatimin e parimeve të standardizimit, në mënyrë që të ndihmojmë sa më shumë biznesin vendas për të qenë pjesë e Tregut Unik Europian dhe për të bërë hapa para drejt integritimit në BE.

Është organizuar një takim me Agjencinë Kosovare të Standardizimit (AKS) më 31.01.2017, në zyrat e DPS, mbi Zbatimin e Marrëveshjes AKS – DPS dhe planin e AKS për adoptime gjatë vitit 2017, si dhe një trajnim i 2 specialistëve të AKS, në datat 26-28 Dhjetor 2017, lidhur me

adoptimet dhe databazën e standardeve, zbatimin e Marrëveshjes së re me CEN&CENELEC e cila prek edhe shitjen e standardeve shqiptare në AKS, notifikimet etj;

Në Maj 2017, DPS nënshkroi Marrëveshjet e reja të bashkëpunimit me CEN dhe CENELEC mbi Statusin e anëtarit pa të drejtë vote (*Affiliate*). Këto Marrëveshje janë në zbatim të Rregullores (BE) 1025/2012 "Për Standardizimin Europian" dhe synojnë të krijojnë rregullat mbi statusin e DPS si *Affiliate* (të drejtat dhe detyrimet) në CEN dhe CENELEC, me qëllim mbështetjen e mëtejshme të qytetarëve dhe biznesit dhe reduktimin e barrierave teknike në tregti në një treg të harmonizuar.

6. Shitja e Standardeve Shqiptare

Janë shitur gjithsej **1,361** standarde, nga të cilat **1,124** janë standarde europiane.

Gjatë vitit 2017 është vërejtur një rritje e kërkesave brenda vendit për blerje standardesh. Janë shitur **713** standarde nga **500** në 2016. Më në detaje tabela e mëposhtë jep numrin e standardeve të kërkuara brenda vendit në vitet 2016 dhe 2017, si dhe fushat ku ka patur më shumë kërkesë:

Viti	Numri total	Standardet më të shitura
2016	500	<ul style="list-style-type: none">- Vlerësimi i Konformitetit - Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të trupave inspektues (ISO / IEC 17020);- Kompetenca e laboratorëve të kalibrimit dhe testimit - Kërkesa të përgjithshme;- Sistemet e menaxhimit të cilësisë (SSH EN ISO 9001) dhe- Sistemet e menaxhimit mjedisor (SSH EN ISO 14001:2015)
2017	713	<ul style="list-style-type: none">- Kërkesat dhe metodat e provës - Lëndët djegëse të lëngëta për automjete - Gasoil (Diesel);- Pajisje dhe aksesorë për rezervuarët/çisternat me gaz të lëngët;- Metodatat e provës për cilësinë e ujit

7. Rritja e pjesëmarrjes në Komitetet Teknike

7 anëtarë të rinj kanë kërkuar të marrin pjesë në Komitetet Teknike të DPS, që mbulojnë fushat:

- ICT;
- Siguria e makinerive dhe siguria kundër zjarrit;
- Ushqimi;
- Ndërtimi;

- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Pajisjet mjeksore.